



Under the auspices of
the Secretary General of
the Council of Europe,
Mr Thorbjørn Jagland



Manifesti Rural Evropian

Miraturar në mbyllje të Parlamentit të Dytë Rural Evropian
të mbajtur më datë 4 deri 6 nëntor 2015 në Schärding, Austri
ku morën pjesë 240 delegatë nga 40 vende evropiane

1. Ne, përfaqësuesit e shumë popujve dhe organizatave të rrënjosur në Evropën rurale, kemi miraturar këtë Manifest Rural Evropian si një deklaratë të aspiratave, përkushtimeve dhe kërkesave të popullsisë rurale, të hartuara mbështetur në takimet e mbajtura në shumë vende gjatë fushatës së Parlamentit Rural Evropian 2015.

2. Diversiteti i rajoneve rurale. Ne e çojmë thellësisht shumëllojshmërinë e gjerë të rajoneve dhe popujve në Evropë, që rrjedh nga gjeomorfologjia e ndryshme, klima dhe biodiversiteti i tokës dhe detit, si dhe nga historia e gjatë e veprimitarisë njerëzore në tërë kontinentin. Ne e shohim këtë shumëllojshmëri të shfaqur në kulturën njerëzore dhe burimet natyrore, si një mundësi tejet të madhe për mirëqenien e ardhshme të të gjithë popujve në Evropë.

3. Vlerat e përbashkëta. Ne i përshëndesim vlerat e përbashkëta, të cilat i lidhin popujt e Evropës, si demokracinë, barazinë, shtetin e së drejtës, njohjen e të drejtave të njeriut dhe frymën e bashkëpunimit. Jemi të mahnitur nga tematikat e përbashkëta që dalin nga fushata e Parlamentit Rural Evropian anembanë Evropës, nga skaji që laget prej Oqeanit Atlantik e deri në Detin e Zi, si dhe nga vendet skandinave deri në Mesdhe.

4. Cilësia e jetës. Ata që jetojnë në zonat rurale të Evropës e çojnë shumë cilësinë e jetës të cilën na fal natyra, fermat, fshatrat dhe qytezat, skajet bregdetare dhe ishujt, malet dhe pyjet, së bashku me kulturat e tyre, peisazhet, florën dhe faunën, mjedisin e shëndetshëm dhe trashëgiminë kulturore.

5. Shqetësimet rreth kushteve të zonave rurale. Megjithatë, ne jemi seriozisht të shqetësuar për faktin se shumë rajone janë të prekur nga zhvillimi i mpakur i ekonomive rurale, mundësitë e mangëta për punë të paguar, humbja e popullsisë për shkak të shpërnguljes së të rinjve e pasojat çekuilibruese demografike, tkurrja e shërbimeve, varfërisë dhe përjashtimit social midis njerëzve të marginalizuar ose minoriteteve etnike si dhe degradimi mjedisor.

6. Nevoja për veprim. Ne besojmë me plot pasion se këto sfida duhen adresuar patjetër, jo vetëm për të mirën e komuniteteve rurale, por edhe të gjithë popujve të Evropës. Të gjithë ne kemi nevojë për ushqim, dru, fibra, energji, ujë dhe minerale të cilat prodhohen në këto zona rurale. Fermerët, sipërmarrjet dhe aktorët e tjerë ruralë krijojnë një pasuri të përbashkët për Evropën. Rajonet rurale japin një kontribut të jashtëzakonshëm në përmirësimin e klimës, argëtimit, shëndetit publik, si dhe mirëqenies sociale, ekonomike dhe shpirtërore.

7. Të drejtat. **Ne mbështesim njohjen e plotë** nga të gjithë popujt dhe institucionet e Evropës të së drejtës së zonave dhe komuniteteve rurale për një jetë cilësore dhe kushte jetese të barabartë me atë të popullsisë urbane, si dhe për pjesëmarrje të tyre të plotë në proceset politike. **Ne i kërkojmë** qeverive të të gjitha niveleve që të mbështesin këtë të drejtë.

Grave dhe burrave duhet t'iu sigurohen të drejta të barabarta, nga çdo pikëpamje të politikave dhe veprimeve lidhur me komunitetet rurale.

8. Vizioni. Vizioni ynë për të ardhmen është ai i Evropës me komunitete rurale të gjallëruara, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, të mbështetur nga ekonomitë e diversifikuara rurale dhe me administrim efikas të një mjedisi dhe trashëgimie kulturore të cilësisë së lartë. **Ne besojmë** se komunitetet rurale të formësuara sipas këtij vizioni, mund të jenë kontribues tkryesorë afatgjatë për një Evropë të begatë, paqësore, të drejtë dhe të barabartë, si dhe për një shoqëri të qëndrueshme globale.

9. Partneriteti. Realizimi i vizionit tonë kërkon prej çdo vendi një partneritet të rindërtuar dhe të barabartë ndërmjet qytetarëve dhe qeverive. Ne, popujt dhe organizatat rurale, jemi të vetëdijshëm se kemi përgjegjësi të prijmë dhe të veprojmë drejt mirëqenies sonë kolektive. **Mirëpo, gjithashtu kërkojmë në mënyrë të drejtë** që qeveritë e të gjitha niveleve, përfshirë dhe institucionet Evropiane, të punojnë për arritjen e këtij partneriteti të rëndësishëm.

10. Shqyrtimi i gjendjes së zonave rurale. **I bëjmë thirrje** Bashkimit Evropian të kryejë një vlerësim të hollësishëm të gjendjes së zonave rurale brenda Bashkimit Evropian, si dhe të kontributit për mirëqenien e Bashkimit Evropian që ofrojnë dhe do të ofrojnë në të ardhmen zonat rurale. Raporti i këtij vlerësimi duhet të botohet në vitin 2017, me rastin e 30 vjetorit të raportit 'E Ardhmja e Shoqërisë Rurale'. Përfundimet e tij duhet të theksohen fort nëpërmjet të gjitha fondeve dhe programeve të BE-së që veprojnë në zonat rurale. Ne duam të përdorim procesin e vazhdueshëm të Parlamentit Rural Evropian në dobi të perpjekjeve për t'iu mundësuar komuniteteve rurale të ndikojnë në përgatitjen e politikave për periudhën përtej vitit 2020.

Ne i kërkojmë Këshillit të Evropës të marrë në konsideratë kryerjen e një vlerësimi të gjendjes dhe nevojave të zonave rurale në të gjitha vendet anëtare të saj.

11. Rikthimi i spirales së rënies. Shumë rajone janë të prekura nga 'spiralja rënëse' në forcën jetësore të komuniteteve rurale. I kja e popullsisë (veçanërisht e të rinjve) shpie në mundësi të reduktuara për shërbime rurale dhe ekonomi lokale të dobësuar, e cila nxit edhe më tej braktisje të këtyre zonave. **Bëjmë thirrje për** përpjekje të përbashkëta nga të gjitha grupet e interesit për zonat rurale, të gjitha agjensitë dhe qeveritë përkatëse që të 'përmbysin spiralen' duke promovuar vlerësimin dhe krenarinë për jetesën në fshat në vend të imponimit të normave urbane, të forcojnë shërbimet rurale, të diversifikojnë ekonomitë rurale, si dhe t'iu mundësojnë të rinjve të qëndrojnë ose të kthehen në zonat rurale.

12. Të rinjtë. Shumë të rinj janë të gatshëm të qëndrojnë ose të shpërngulen në zonat rurale dhe të marrin përsipër, si fermerë, sipërmarrës ruralë apo si qytetarë, përgjegjësinë për mirëqenien e ardhshme të ekonomive dhe komuniteteve rurale. Të rinjtë kanë nevojë për mundësi tërheqëse punësimi, sisteme të mirëpërgamtuara të arsimit dhe edukimit profesional, dhënien e eksperiencës ndaj brezave të rinj bazuar në nevojat lokale, qasje në tokë, strehim dhe kredi, aktivitete sociale dhe kulturore të përshtatura për të rinjtë, si dhe përkrahje konkrete për fermerët dhe sipërmarrësit. **I bëjmë thirrje** qeverive dhe shoqërisë civile të përmbushin këto nevoja dhe t'iu mundësojnë të rinjve të marrin pjesë aktive në proceset politike.

Ne mbështesim thirrjen e drejtuar ndaj të rinjve në zonat rurale që të kenë Parlamentët e tyre Rurale për të Rinj si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel Evropian.

13. Refugjatët. Arritja e njerëzve të pashpresë nga zonat e konfliktit dhe katastrofave, duke kërkuar strehë dhe jetë të re në Evropë, po nxit konsideratë dhe veprime brenda rrjeteve tona. Ndërsa i u kërkojmë qeverive dhe agjencive të punojnë më urgjentisht për të zgjidhur shkaqet e kësaj krize, ne **bëjmë thirrje** dhe për një reagim të ngrohtë, bazuar në solidaritetin ndërmjet popujve. Besojmë se për shumë zona rurale, madje dhe për ato me popullsi në rënie, kjo ofron një mundësi për të integruar refugjatët dhe të porsaardhurit e tjerë. Procesi i integritit patjetër duhet të përfshijë krijimin e domosdoshëm të vendeve të punës, investimeve në strehim, shërbimeve dhe infrastrukturës. Përpjekjet për integrim të suksesshëm duhet të përshëndeten.

14. Varfëria dhe përjashtimi. Ne njohim progresin që është bërë në luftën ndaj varfërisë dhe përjashtimit social në Evropë. Mirëpo, miliona njerëz ende janë të prekur nga varfëria dhe përjashtim social të llojeve të ndryshme. Kohezioni social dhe territorial janë pjesë përbërëse e vizionit tonë për Evropën. **Bëjmë thirrje për** përpjekje të qëndrueshme për promovimin e gjithëpërfshirjes dhe pjesëmarrjes së plotë në shoqëri. Shqetësim të veçantë paraqesin nevojat e komuniteteve Rome në shumë vende evropiane, të cilët janë ndër më të varfërit dhe më të përjashtuarit nga të gjithë popullatat rurale të Evropës. Ata duhet të njihen si qytetarë me të drejta të barabarta për mundësim të arsimit dhe punësimit të përshtatshëm për fëmijët e tyre. Të gjithë njerëzit kanë talent dhe aftësi për të ofruar.

15. LEADER dhe CLLD. Ne mbrojmë fuqimisht idenë e qasjes territoriale, të integruar dhe bazuar në partneritete, që priret nga një frymë që vjen prej së poshtmi dhe e lidhur fort me vendin. Ne dëshirojmë të shohim zbatimin e gjerë të parimit LEADER dhe përhapjen e tij në Zhvillimin e Drejtuar nga Komuniteti Lokal (ang. Community Led Local Development-CLLD) si brenda ashtu edhe jashtë BE-së. Jemi mjaft të shqetësuar për mungesën aktuale, në shumë vende, të një procesi të vërtetë të integruar të zhvillimit rural dhe rajonal. **I bëjmë thirrje** institucioneve dhe qeverive brenda BE-së të tregojnë besim në Grupet Lokale të Veprimit, të zgjerojnë financimin ndaj tyre, të miratojnë rregulloret dhe procedurat për nevojat e komuniteteve rurale, si dhe të sigurojnë një qasje të vërtetë të integruar ndaj zhvillimit lokal e të shfrytëzojnë fonde të shumëfishta. I bëjmë thirrje të gjithë sektorëve në Ballkanin Perëndimor dhe vendeve të Detit të Zi të zgjerojnë rrugën e partneriteti ndërmjet sektorëve për shfrytëzimin e LEADER dhe CLLD.

16. Infrastruktura dhe shërbimet rurale. Shërbimet rurale themelore, siç janë dyqanet, shërbimet postare, shkollat, shërbimi shëndetësor primar, transporti publik, si dhe infrastruktura sociale, janë jetike për mbështetjen e cilësisë së jetës në zonat rurale. Infrastruktura fizike adekuate – furnizimi me ujë, sistemet e kanalizimit, si dhe energjia elektrike, furnizimi me energji, sistemet e transportit – është gjithashtu jetike. Mirëpo, në shumë zona rurale, shërbimet rurale janë tashmë të dobëta ose po humben, ndërsa infrastruktura është joadekuate, çka mund të krijojë kushtet për një rreth vicioz rënës. **I bëjmë thirrje** qeverive dhe ofruesve të shërbimeve të njohin të drejtën e popujve ruralë për infrastrukturë adekuate dhe qasje të arsyeshme në të gjitha shërbimet themelore, si dhe t’iu mundësojnë komuniteteve rurale të marrin vendime dhe veprime për të siguruar shërbimet dhe infrastrukturën për nevojat e tyre.

17. Komunikimi me valë të gjerë (broadband) dhe celular. Qasja në telekomunikime me kapacitet të lartë po bëhet gjithnjë e më tepër e rëndësishme për jetën sociale, kulturore dhe ekonomike të të gjithë evropianëve si dhe për ofrimin e shërbimeve jetike. Për shkak të

distancës së tyre dhe popullsisë së rrallë, zonat rurale kanë nevoja të veçanta për mjete komunikimi efikase. Megjithatë, shumë zona rurale, veçanërisht në Evropën Lindore dhe rajonet periferike të BE-së, janë në disavantazh të madh për shkak të dobësive në sistemet e telekomunikimit. **I bëjmë thirrje** qeverive, financuesve shumëkombësh dhe ofruesve të shërbimeve të telekomunikimit të punojnë urgjentisht drejt mundësisë të qasjes ndaj shërbimeve të shpejta celulare dhe mjeteve me vale të gjerë (broadband) për të gjithë popullsitë rurale, si dhe aty ku paraqitet nevoja, t'iu mundësojnë komuniteteve rurale që ata vetë të ndërmarrin veprime për të siguruar këtë shërbim.

18. Ekonomitë lokale dhe nënrajonale. Rajonet rurale të Evropës përfshijnë mijëra ekonomi lokale dhe nënrajonale, të pasura me sipërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme, të cilët e formojnë jetën e komuniteteve dhe kontribuojnë në masë të madhe në ekonomitë më të mëdha të kombeve evropiane. **Ne mbrojmë** rëndësinë e madhe për rritjen e vitalitetit dhe qëndrueshmërisë së këtyre ekonomive lokale dhe nënrajonale anembanë Evropës rurale. Mjetet për realizimin e këtij qëllimi do të dallojnë nga vendi në vend, mirëpo mund të mbështeten inisiativa në shumë sektorë të ndryshëm – bujqësi, pyje, peshkim, prodhim të energjisë, industrinë e përpunimit përfshirë dhe sipërmarrjet me vlerë të shtuar, zinxhirët e furnizimit, turizmin dhe sektorin e shërbimeve, përfshirë dhe bizneset që mbështeten në teknologjinë e informacionit. Ekziston një hapësirë e madhe për sipërmarrjet sociale. Rëndësi të madhe ka dhe ofrimi i shërbimeve të zhdërvjellta të këshillimit, të mbështetjes së biznesit dhe kreditimit, si dhe arsimit dhe trajnimit profesional, të përshtatur në mënyrë të përpiktë për mundësitë ekzistuese dhe potenciale të punësimit.

19. Fermat e vogla dhe familjare. Ne njohim kontributin e madh që fermat komerciale japin për ekonominë evropiane. Mirëpo, jemi seriozisht të shqetësuar për humbjen e fuqisë së punës të fermave dhe për mirëqenien e shumë miliona fermave të vogla dhe familjare, brenda BE-së, Evropës Juglindore dhe Rajonit të Detit të Zi, veçanërisht në zonat e largëta, male dhe ishuj. Këto ferma sigurojnë jetesë për miliona familje, sigurojnë ushqim për tregjet lokale, paraqesin faktorin kryesor të popullsisë së miliona komuniteteve dhe i ruajnë mënyrat tradicionale të jetës nga të cilat varen shëndeti i tokës, peizazhet, ekosistemet dhe trashëgimia kulturore. Ata mund të ruajnë qëndrueshmërinë me formimin e kooperativave dhe sipërmarrjeve bujqësore sociale, duke i shtuar vlerë prodhimeve të tyre në mënyrë kolektive, duke i diversifikuar të ardhurat e fermave të tyre dhe ekonomive lokale, si dhe duke formuar gradualisht njësi më të mëdha të tokës. **Iu bëjmë thirrje** qeverive, donatorëve, organizatave të shoqërisë civile dhe komuniteteve rurale të njohin dhe përkrahin fermat familjare si një model i qëndrueshëm evropian.

20. Qytezat. Qytezat, të cilat janë me mijëra në Evropë, kanë rëndësi jetike si qendra sociale, ekonomike dhe kulturore për komunitetet rurale. Ata janë qendrat e tregtisë, shërbimeve publike dhe sociale, shkollave të mesme dhe kujdesit shëndetësor; ofrojnë mundësi të mëdha për turizmin; dhe së bashku përbëjnë kontribut të madh në ekonomitë rajonale dhe kombëtare. Megjithatë, ata nuk njihen si një objektiv kryesor i programeve dhe politikave kombëtare dhe evropiane ku shpeshherë nuk shihen as si qyteza urbane as rurale. **Ne mbështesim** politika të harmonizuara të Bashkimit Evropian për qytezat, duke njohur të gjitha kontributet e rëndësishme të tyre në strukturat ekonomike dhe sociale të rajoneve rurale dhe vitalitetin e tyre; dhe për një përqendrim më të madh në adresimin e nevojave të qytezave brenda politikave kombëtare.

Ne bëjmë thirrje për një rritje të bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve, organizatave dhe autoriteteve në zonat rurale dhe urbane me qëllim arritjen e përfitimit të plotë nga lidhjet

sociale, kulturore dhe ekonomike që mund t'i ofrojë një bashkëpunim i tillë; si dhe për shkëmbim energjik të ideve dhe praktikave të mira ndërmjet palëve të përfshira në zonat rurale dhe urbane.

21. Ndryshimet klimatike dhe burimet natyrore. Në prag të Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, **ne mbrojmë** rolin e madh që mund ta luajnë zonat rurale të Evropës në luftimin e ndryshimeve klimatike dhe ruajtjen e burimeve të mjedisore; dhe gjithashtu e njohim nevojën për të ndihmuar zonat rurale t'u përshtaten ndryshimeve klimatike. Mbi 40 përqind e sipërfaqes së tokës në Evropë janë pyje, të cilat mund të përthithin karbonin dhe të cilat kontribuojnë në masë të madhe në burimet e rinovueshme të lëndës së parë dhe energjisë. Zonat rurale janë të mirëpozicionuara për të përmbushur nevojat në rritje për energji të rinovueshme nga era, uji, baticat, energjia solare, burimet gjeotermike dhe lënda drusore djegëse, në mënyra që respektojnë natyrën e paprekur dhe mjedisin e tokës dhe ujit, si dhe u sjellin komuniteteve rurale përfitime të drejtëpërdrejta dhe punësim. **Ne bëjmë thirrje për** shfrytëzim në rritje të aksesit ndaj agro-pylltarisë, agro-ekologjisë dhe bio-ekonomisë. **Gjithashtu bëjmë thirrje** që kushtet e krijuara nga ndryshimet klimatike të merren parasysh në përcaktimin e rajoneve të marginalizuara në kuadër të vlerësimit të alokimit të mbështetjes financiare.

22. Ballkani Perëndimor dhe Evropa Juglindore. Komunitetet rurale dhe ekonomitë e Ballkanit Perëndimor dhe vendeve të Evropës Juglindore janë thellësisht të prekur nga paqëndrueshmëria politike në rajon. Procesi i anëtarësimit në BE është pezull. Kjo e ngadalëson procesin e reformave politike. Zhvillimi rural shihet nga qeveritë si një prioritet i ulët. **Ne i bëjmë thirrje** BE-së që ta rigjallërojë procesin e anëtarësimit në këtë rajon, duke përfshirë përkrahje më efektive për proceset e zhvillimit rural.

23. Lidershipi në zhvillimin rural. Ne njohim rëndësinë e rolit të lidërshiptit në të gjitha nivelet dhe ndërmjet tyre. Ne pranojmë që përgjegjësia parësore për identifikimin e nevojave dhe ofrimin e zgjidhjeve qëndron tek ne, aktorët ruralë. Megjithatë, lidërshipti në zhvillimin rural përfshin veprime kolektive nga nivelet lokale, rajonale, kombëtare dhe evropiane, si dhe karakterizohet nga përkushtimi, komunikimi, bashkëpunimi dhe ndërtimi i besimit. **I bëjmë thirrje** shoqërisë civile, qeverive dhe sektorit privat të punojnë në partneritet për të ofruar ngritje të kapaciteteve, burime dhe përkrahje për të nxitur një mjedis që inkurajon lidërshipt novator, të qëndrueshëm dhe llogaridhënës, duke i frymëzuar dhe angazhuar liderët e ardhshëm.

24. Rrjetet e shoqërisë qytetare. Rrjetet kombëtare dhe evropiane të cilat e kanë drejtuar këtë fushatë të Parlamentit Rural Evropian janë mbështet në veprime lokale dhe demokraci pjesëmarrëse. Anëtarësia e tyre përfshin mijëra grupe veprimi në nivel fshattrash, shoqata lokale, kooperativa dhe struktura të tjera, të cilat ofrojnë shërbime thelbësore dhe promovojnë bashkëpunimin midis aktorëve ruralë. **I bëjmë thirrje** qeverive dhe institucioneve evropiane të respektojnë pavarësinë e OJQ-ve dhe rrjeteve të tyre dhe të mbështesin aktivitetet e tyre.

25. Partneriteti ndërmjet shoqësisë civile dhe qeverive. Besojmë se zhvillimi efikas rural kërkon një partneritet novator dhe pa paragjykime ndërmjet popujve dhe qeverive, krah për krah si të barabartë. **I bëjmë thirrje** grupeve rurale të interesit të bashkëpunojnë me qeveritë; ndërsa qeveritë, institucionet ndërkombëtare dhe agjencitë përkatëse të themelojnë sisteme domethënëse për vendim-marrje bazuar në konsultime dhe bashkëpunim, me qëllim që t'u mundësojë palëve rurale të interesit të marrin pjesë në hartimin dhe zbatimin e politikave, si

dhe të vënë themelet e fuqishme për një partneritet të frytshëm ndërmjet grupeve rurale të interesit dhe qeverive në të gjitha nivelet.

26. Klima përkrahëse. I bëjmë thirrje qeverive të veprojnë në frymën e partneritetit të gjerë dhe besimplotë me komunitetet rurale, duke e njohur të drejtën e tyre për vetëvendosje; dhe të ofrojnë klimë përkrahëse në fushën juridike, legislative, administrative dhe financiare. Kjo klimë përkrahëse duhet të përfshijë përkushtimin e plotë në demokraci dhe shtetin e së drejtës; në koherencë ndërmjet aspekteve të ndryshme dhe niveleve gjeografike të politikave që i përkasin fushës së veprimit të qeverisë në drejtim të zonave rurale; ruajtjen e aspektit rural të hartimit të politikave dhe programeve përkatëse; hartimin me thjeshtësi, si dhe zbatimin fleksibël dhe sensitiv të sistemeve rregullatore, fiskale dhe financiare për të inkurajuar inisiativa nga individë, sipërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme, sipërmarrje sociale, kooperativa dhe të tjera si këto; dhe të respektohen të drejtat e komuniteteve rurale gjatë hartimit të traktateve dhe ligjeve ndërkombëtare.

27. Arsimi. Në një botë që gjithnjë ndryshon, njerëzit kudo kanë nevojë për rritje të vazhdueshme të aftësive të tyre për t'u përshtatur dhe për të krijuar risi në veprimtarinë sociale dhe ekonomike. Për këtë arsye, arsimit dhe mësimi i përjetshëm – duke filluar që nga fëmijëria e hershme – zënë një vend të konsiderueshëm në mundësimin e komuniteteve rurale për të lulëzuar, me rrjetëzimin dhe bashkëpunimin e nevojshëm, si dhe për të marrë pjesë plotësisht në proceset zhvillimore. Ato kanë rëndësi të veçantë për t'iu mundësuar të rinjve të kuptojnë mundësitë për një jetë të pasur dhe të qëndrueshme në natyrë, të përftojnë dhe vazhdimisht të rifreskojnë aftësitë e nevojshme, si dhe të marrin pjesë si qytetarë. I bëjmë thirrje institucioneve arsimore të sigurojnë për komunitetet rurale qasje efektive në shërbimet arsimore, përfshirë dhe mësimin në distancë dhe trajnimin profesional të përshtatur sipas nevojave të jetesës në zonat rurale.

28. Shkëmbimet ndërkombëtare. Ne besojmë se puna për të arritur zhvillim të qëndrueshëm rural në tërë Evropën e më gjerë mund të ndihmohet dhe përshpejtohet në masë të madhe me shkëmbimin e praktikave të mira ndërmjet palëve rurale të interesit dhe qeverive në të gjitha vendet evropiane dhe më tej. Lindja dhe Perëndimi mund të kontribuojnë njësoj dhe të përfitojnë nga ato shkëmbime. Ne **bëjmë thirrje për** një qasje të vertetë Pan-evropiane në shkëmbimin e programeve, nëpërmjet bashkëpunimit ndërmjet qeverive, OJQ-ve, donatorëve shumëkombësh dhe të tjerë aktorëve brenda dhe jashtë BE-së. Një kontribut kryesor në këtë proces duhet ofruar nga Rrjeti Evropian për Zhvillim Rural dhe Rrjetet Kombëtare Rurale të financuara nga BE-ja në të gjithë vendet anëtare të BE-së.

29. Advokimi dhe veprimi. I kërkojmë Rrjetet evropiane të OJQ-ve të cilat ishin bashkëpunëtorë në organizimin e Parlamentit të Dytë Rural Evropian të prijnë një program advokimi dhe veprimi bazuar në këtë Manifest, duke bashkëpunuar ngushtë me anëtarësitë e tyre kombëtare dhe të gjithë partnerët e gatshëm.

30. Zotimi ynë. Ne zotohemi në përkushtimin tonë të vazhdueshëm për ndjekjen e vizionit dhe aktiviteteve të përshkruara në këtë Manifest. Ne besojmë se komunitetet rurale, qeveritë dhe institucionet ndërkombëtare, duke punuar së bashku, mund të arrijnë rilindjen e rajoneve rurale në Evropë. Me këtë bindje, deklarojmë se **E Tërë Evropa do të Jetojë!**

Shënim shpjegues

Fushata e Parlamentit Rural Evropian 2015 u organizuar nga tre Organizata Joqeveritare Pan-evropiane – Aleanca Evropiane e Komuniteteve Rurale, PREPARE Partneriteti për Evropë Rurale, si dhe Shoqata Evropiane LEADER për Zhvillim Rural. Kjo përfshiu fushata kombëtare për grumbullim të ideve nga komunitetet rurale në 36 shtete evropiane; konferenca rajonale ose Parlamente Rurale në shumicën e këtyre shteteve; si dhe Parlamentin Rural Evropian treditör me pjesëmarrje të grupeve rurale të interesit nga 40 shtete, si dhe përfaqësues të qeverive dhe institucioneve ndërkombëtare. Ky Manifest do të krijojë bazën për realizimin e fushatave të vazhdueshme nga tre entitetet organizatore dhe partnerët e tyre kombëtarë.



Co-funded by the
Europe for Citizens Programme
of the European Union

MIT UNTERSTÜTZUNG VON BUND, LAND UND EUROPÄISCHER UNION



Europäischer
Landwirtschaftsfonds für
die Entwicklung des
ländlichen Raumes
Hier verbindet Europa mit
dem ländlichen Gebiet

